



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:051343  
Datë: 08.06.2021  
Numri i dokumentit: 01862649

P.nr.807/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashica, në çështjen penale kundër të pandehurit A. N. nga Gjilani, për shkak të veprës penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 i KPRK-së, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Armend Ahmeti nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani me numër PP.II.nr.1345/18, të datës 07.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 27.05.2021 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me date 08.06.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri A. N., nga babai Xh. dhe nëna L., e lindur Sh., i lindur me datë 07.04.1989 në Gjilani ku edhe jeton në rrugën “Shadërvani”, numër 78, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i një fëmije, i pa punë, i gjendje së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Serbisë,

ËSHTË FAJTOR

Sepse në muajin nëntor – dhjetor 2017 në kohë të papërcaktuar në shtëpinë e përbashkët familjare në Gjilani me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka keqpërdorur besimin e prindërve të vet, tani të dëmtuarave Xh. dhe L. N. nga Gjilani në atë mënyrë që i pandehuri ka shfrytëzuar rastin kur prindërit e tij nuk kanë qenë në shtëpi, i njëjti e merr automjetin e udhëtareve të markës BMW 640X Drive me numër të identifikimit WBA6A81010D368049, me numër të librezës së qarkullimit zviceran numër 556.265.215 e çregjistruar, pronë e përbashkët e prindërve të vet, të njëjtin automjet pa pasur autorizim dhe të drejtë ia shet një personi me emrin B. nga Prishtina dhe pas kësaj, rasti lajmërohet në polici ndërsa më vonë të dëmtuarit Xh. dhe L. pajtohen me kontraktimin e shitjes së automjetit të bërë në mes A. dhe blerësit B. nga Prishtina, vetëm për faktin e mos acarimit të raporteve në familje dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta ka keqpërdor besimin e prindërve të vet – të dëmtuarave dhe të njëjtëve iu ka shkaktuar dëm material në shumë të papërcaktuar,

-Me çka ka kryer veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4,41,42,43,46,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehurin A. N.:

## E GJYKON

Me dënim gjobë në shumë prej 400 € (katërqind eurove) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje që ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Të dëmtuarit Xh. dhe L. N. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan- Departamenti i Përgjithshëm me datë 11.09.2018, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1345/2018 kundër të pandehurit A. N. nga Gjiilani për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-se.

Më datë 27.05.2021 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori shtetit, i pandehuri A. N. dhe mbrojtësi i tij me autorizimi avokati Armend Ahmeti, me ç'rast para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka bërë ricilësimin juridik nga vepra penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës në veprën penale keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 i KPRK-së dhe më pas ka vazhduar me leximin e aktakuzës me ricilësimin e ri juridik ndërsa i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë dhe pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-ës gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit NJHP#052-18-2018-CA-706 i datës 07.07.2018, deklaratat e të dëmtuarës L. N. e dhënë në Stacionin Policor në Gjiilan, deklaratat e të pandehurit A. N. e dhënë në Stacionin Policor në Gjiilan, fotokopja e lejes së qarkullimit për automjet BMW, raporti i oficerit, foto dokumentacioni si

dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuzat lëndore nuk përmban asnjë shkëlqje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri A. N. nga Gjilani ka kryer veprën penale keqpërdorni i besimit nga neni 342 paragrafi 1 i KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i pandehuri me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija dhe veprën penale e ka kryer me dashje, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit si dhe pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, u ka kërkuar falje të dëmtuarave për këto veprime, po ashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale si dhe faktin se për të njëjtin ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale po ashtu si rrethanë lehtësuese për të gjykata mori edhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale meqenëse i njëjti më asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin dhe me të dëmtuarit-prindërit e tij i ka rregulluar raportet dhe më nuk kanë pasur probleme ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit e cila nga provat e çështjes del të jetë e lartë për faktin se i pandehuri këtë vepër e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke e ditur se është duke e keqpërdorur besimin e prindërve të tij për faktin se nuk kishte autorizim për shitjen e automjetit të lartcekur dhe përkundër kësaj i njëjti ka dëshiruar dhe ka ndërmarrë veprimet siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi për shkaktimin e pasojës së ndaluar, po ashtu si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori edhe faktin se vepra penale është kryer brenda ambientit familjar gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 76 të KPRK-ës gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim me burgim deri në 5 vite vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale ndërsa me rastin e marrjes së vendimit për lartësinë e dënimit me gjobë gjykata pati parasysh gjendjen ekonomike të të pandehurit duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar të njëjtit por as familjarëve të tij nuk u rrezikohet mirëqenia ekonomike.

5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit Xh. dhe L. N. i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € si shumën prej 30 € për kompensimin e viktimave të kriminit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.807/2018, me datë 08.06.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.